



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRRIMIN E QYTYRIT
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 33537
U. Br.

Nr. i faq. 2 Data: 21/10
Br. str. Datum:

KAMENICA 2024

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e II-te e Komitetit per Zhvillim Ekonomik

Mbledhja u mbajt ne objektin e komunës me datë 10.05.2024 dhe filloi nga ora 17:30. Në mbledhje ishte e pranishme edhe drejtoresha .

Mbledhjen e -II-rë (të rregullt) të Komitetit për Zhvillim Ekonomik e cila do të mbahet ditën e **Premte** me datë: **10.05.2024**, duke filluar nga ora 17:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi kryesuesja e Komitetit per Zhvillim Ekonomik, Albana Ajvazi.

Albana Ajvazi: Për mbledhje propozoj këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi I procesverbalit te mbledhjes se kaluar

2. Plani i punës së komitetit

3. Të ndryshme

Albana Ajvazi: A keni ndonje propozim per kete mbledhje?

Drejtoresha Burbuqe Leka: Propozoj per pergatitjen e planit te punes.

Drejtoria e planifikojne buxhetin per vitin 2025, qka mundet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik me bo dhe me ofru per bizneset.

Te behet shperndarja e rregulloreve te kuvendit tek bizneset .

Jane duke u be disa plotesim ndryshime te rregulloreve per subvebcione.

Valdete Sopi: Pra mund te themi se Plani I Punes per kete Komitet te jete keshtu:

Mbi 3 takime ne vit, qdo 3muaj.

Thirrje publike per panaire, te financohen bizneset dhe te mbeshketen .

Drejtoresha: Propozoj vizite bizneseve te ndryshme ose organizim nga ana e komitetit per takimin e bizneseve.

Gjate ketyre takimev si qeshtje diskutimi te jene problemet qe I prekin bizneset, sfidat e ndryshme qe kane ne perditshmeri si dhe problematika e tanishme qe po hasin me fuqine punetore te zvogeluar, qfare plani kane ata per kete qeshtje dhe qka mundemi ne si Komitet per Zhvillim Ekonomik me ju ndihmu ketyre bizneseve.

Kadrije Mustafa: Pershendetje, unë kisha kërkuar që drejtoria e juaj të organizoj trajnime se si të bëjmë një biznes plan sepse kur ministrite apo edhe komunat, organizata shpallin ndonji thirrje publike për ndihmë bizneseve, ne si gra që përfaqesojmë bizneset po kemi shumë problem me e hartu një biznes plan.

Ibadete Sadiku: Gjithashtu edhe unë kisha propozuar që të ftoni ndonjë organizatë apo ju si komunë që të bëni më shumë trajnime për bizneset si p.sh. rreth amballazhimit të produkteve që ne I prodhojmë apo rreth marketingut.

Albana Ajvazi: Ne i morëm propozimet e juaja dhe nese nuk keni diqka tjeter per te shtuar, e mbyllim kete mbledhje.

Kryesuesi i Komitetit



Albana Ajvazi